



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 197 Akti

Nr. 211 Vendimi  
Tiranë, më 18.11.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Xhensila Pine</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Roland Ilia</b>	<b>Relator</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Mia Roessingh, në datën 6.11.2019, ora 14:00 dhe datën 11.11.2019, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Arjan Balliu**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Arjan Balliu, vëzhguesen ndërkombëtare, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 5 dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2, të nenin 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 17.9.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Valbona Sanxhaktari dhe Xhensila Pine. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisioneri Roland Ilia.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 23.9.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuese komisionere Xhensila Pine, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.
5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me subjektin.
7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.
8. Në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, u administrua shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 12.12.2018, e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), me anë të së cilës është dërguar një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.
9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.
10. Për këtë qëllim, DSIK-ja, ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*\*, datë

01.03.2019), në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Arjan Balliu.*

11. Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit me nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2019.

12. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, duke filluar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi tria kriteret e vlerësimit: vlerësimit të pasurisë; kontrollit të figurës; dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

13. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë në datën 18.9.2019, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t`u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

14. Subjekti i rivlerësimit, në datën 18.9.2019, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 20.9.2019 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më 17.10.2019.

15. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit është njohur me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet e saj në rrugë zyrtare, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 28.10.2019, vendosi të ftojë z. Arjan Balliu, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail*, në datën 28.10.2019.

Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Arjan Balliu, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 6.11.2019, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

Subjekti paraqiti kërkesë për çeljen e hetimit për dy kriteret e tjerë të vlerësimit, si dhe përjashtimin e relatorit të çështjes gjatë seancës dëgjimore në datën 06.11.2019, ora 14:00. Pasi u administrua kërkesa e subjektit të rivlerësimit, u vendos ngritja e trupit të ri gjykues në datën 7.11.2019, i cili e shqyrtoi këtë kërkesë të subjektit për përjashtimin e relatorit dhe vendosi mospranimin e saj. Ky vendim iu bë me dije subjektit të rivlerësimit në rrugë elektronike dhe postare në datën 7.11.2019. Ndërsa me vendimin nr. 6, datë 8.11.2019, trupi gjykues vendosi mospranimin e kërkesës së subjektit për riçeljen e hetimit administrativ për dy kriteret e tjerë,

vendim i cili iu bë me dije në rrugë elektronike po në këtë datë. Seanca dëgjimore e radhës u zhvillua në datën 11.11.2019, ora 14:00.

Subjekti i rivlerësimit, në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Z. Arjan Balliu ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur ato janë kërkuar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

Referuar vendimit Nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklarata e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI; ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet

publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) administruar raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja (dh) administruar raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; (e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Komisioni, nisur nga fakti dhe nga konstatimet e gjetura mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, i kaloi barrën e provës subjektit, për të provuar të kundërtën e këtyre gjetjeve.

## **V. VLERËSIMI I PASURISË**

### **1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

Në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë ndër vite nga bashkëshortja (subjekt deklarues) në vitin 2007;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti ka ushtruar funksionin në situatën e konfliktit të interesave.*

### **2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni.**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komisionin nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimi e deklarimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Arjan Balliu, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, dhe aktit të kontrollit me nr. indeksi \*\*\*, datës 12.12.2018, të ILDKPKI-së për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI, për vitet 2003 - 2017, në raport me të dhënat e “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga bankat, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimeve të kryera lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

## **Në deklaratën e pasurisë “Vetting” të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto pasuri:**

**1. Apartament 1+1+aneks**, me sip. 70.8 m<sup>2</sup>, së bashku me garazh me sip. 12.5 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z.k. \*\*\*, ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, Blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 16.7.2001, në vlerën 28.000 USD.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhurat nga paga dhe kursimet e prindërve. Pjesa takuese: 100 %.

### **Konstatimi i ILDKPKI-së**

- Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e prindërve, të cilat kanë përbërë burim për blerjen e apartamentit, si dhe nuk ka përcaktuar se kanë qenë këto të ardhura.
- Subjekti ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor dhe burimi të ligjshëm financiar për blerjen e apartamentit me sip.70.8 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, në vitin 2001, në vlerën 28.000 USD.
- Fshehje në deklarin “Vetting” të dhuratës në shumën prej 15.000 USD nga babai i bashkëshortes, z. N.V., për blerjen e apartamentit me sip.70.8 m<sup>2</sup> në vitin 2001.
- Deklarim i rremë dhe kontratë fiktive e shitjes me nr. \*\*\*, datë 7.4.2012, me palë shitëse z. Arjan Balliu dhe palë blerëse znj. L.V., për shitjen e apartamentit me sip.70.8 m<sup>2</sup>, në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, në vlerën 8.800.000 lekë, me qëllim krijimin e burimeve financiare për blerjen e automjetit tip “Audi” në vlerën 25.000 euro.
- Subjekti nuk ka deklaruar në deklarin “Vetting” garazhin me sip. 12.5 m<sup>2</sup>, i cili ndodhet në të njëjtin pallat me apartamentin që i është shitur nënës së bashkëshortes.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri të paluajshme në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003 me përshkrimin: *“apartament 1+1+A, me sip. 70.8 m<sup>2</sup>, së bashku me garazh me sip. 12.5 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”, pall. \*\*\*, Tiranë. Vlera: 28.000 USD. Nga kursimet personale+kursime bashkëshortja + dhuratë 15.000 USD nga vjehri, z. N.V.”.*

Subjekti i rivlerësimit ka qenë subjekt deklarues i pasurisë në vitin 2003, për “deklarimin dhe kontrollin e pasurisë së tij”, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, pasi në këtë periudhë ushtronte funksionin e drejtorit në Drejtorinë e Lojërave të Fatit në Ministrinë e Financave.

Rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri edhe në deklaratën para fillimit të detyrës si inspektor pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë në vitin 2009 me përshkrimin: *“apartament 1+1+A, me sip. 70.8 m<sup>2</sup>, së bashku me garazh me sip. 12.5 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”, pall. \*\*\*, Tiranë me kontratën nr. \*\*\*, datë 16.7.2001, në vlerën 28.000 USD. Zotërimi 100%”.*

Kjo pasuri është blerë nga subjekti me kontratën nr. \*\*\*, datë 16.7.2001. Pasuria është shitur nga shoqëria “P.G.” sh.p.k., në vlerën 28.000 USD. Bashkë me pasurinë apartament është blerë dhe garazh me sip. 12.5 m<sup>2</sup>, në të njëjtin objekt ndërtimor.

Për këtë pasuri është lëshuar dhe certifikatë provizore për regjistrimin karabina në datën 29.3.2012, nga ZVRPP-ja Tiranë, ku përcaktohet se është bërë rivlerësimi i pasurisë në vlerën 8.800.000 lekë.

Kjo pasuri është shitur më pas nga subjekti me kontratën me nr. \*\*\*, datë 7.4.2012, në vlerën 8.800.000 lekë. Rezultoi se kjo pasuri është blerë nga vjehra e subjektit, znj. L.V. Vlera e kontratës është shlyer totalisht jashtë zyrës noteriale. Nga subjekti nuk është dokumentuar

kalimi i shumës totale së shitjes së pasurisë nga blerësja në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, që do të provonte faktin e shlyerjes së detyrime kontraktore midis palëve.

Në deklaratën vjetore të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të ardhura nga kursimet e prindërve, vjehrrit, vjehrrës dhe vlerat përkatëse për kontributin e tyre për blerjen e kësaj pasurie, si dhe nuk ka dokumentuar të ardhurat e ligjshme të prindërve.

Sipas deklaratës para fillimit të detyrës të vitit 2003 të plotësuar nga bashkëshortja e subjektit rezulton se burimi i blerjes së kësaj pasurie është: kursime personale+kursime nga bashkëshortja+dhuratë vjehrrit, z. N.V., në vlerën 15.000 USD. Për këtë dhurim subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor, si dhe burimin e krijimit të kësaj shume nga vjehrrit i tij, z. N.V.

Ky apartament i është shitur vjehrrës së subjektit, znj. L.V., në vlerën prej 8.800.000 lekë, ndërkohë që sipas deklaratimit në deklaratat vjetore periodike të dorëzuara në ILDKPKI, nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, kontributi i deklaruar për blerjen e po kësaj pasurie ishte dhurim nga vjehrrit në vlerën 50 % të vlerës totale të blerjes së pasurisë.

Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri si pasuri në pronësi të tij 100 % , në kundërshtim me deklaratimet e mëvonshme dhe nuk është deklaruar si pasuri e shitur.

Gjithashtu, subjekti po në vitin 2012, ka deklaruar blerjen e një pasurie automjet në vlerën 25.000 euro, për të cilën ka deklaruar se burimi është nga të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie apartament dhe kursimet nga paga. Diferenca e pretenduar (likuiditetet), si pasuri e krijuar nga të ardhurat e apartamentit të shitur nuk janë deklaruar asnjëherë nga subjekti në deklaratën periodike vjetore për vitin 2012 dhe as për vitet në vijim (detyrim i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003).

Në përgjigje të një pyetësori subjekti ka deklaruar se pas shitjes së kësaj pasurie në vitin 2012, ka banuar në të njëjtën adresë dhe në të njëjtin pallat, por në një apartament tjetër në pronësi të babait të tij, pasuri e cila nuk është deklaruar në deklaratën “Vetting” nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioni, përveç gjetjeve të konstatuar nga ILDKPKI-ja për këtë pasuri, konstatoi dhe problematika të tjera, si më poshtë:

- Subjekti megjithëse e ka shitur këtë pasuri në vitin 2012 e ka deklaruar në deklaratën “Vetting” si pasuri në pronësi të tij me pjesë takuese 100 %, e cila përforcoi faktin se kjo shitje e bërë për këtë pasuri ka qenë fiktive.
- Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” pasurinë në posedim dhe në përdorim në njëjtën adresë: Rr. “\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, e cila është në posedimin e tij që nga viti 2012, si dhe as burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie (detyrim i ligjit nr. 84/2016).
- Në deklaratën e fillimit të detyrës të vitit 2003, subjekti ka deklaruar se një pjesë e shumës për blerjen e kësaj pasurie është dhënë dhuratë nga vjehrrit i tij, z. N.V., në vlerën 15.000 USD. Në deklaratën “Vetting” dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi vlerën prej 1.000.000 lekësh, si kontribut të babait të tij, si një pjesë e vlerës për këtë pasuri. Pra, nga subjekti janë dhënë deklarime kontradiktore lidhur me burimin financiar për përballimin e një pjese për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme.
- Në deklaratën periodike për vitin 2012 nuk është deklaruar shuma e plotë e pretenduar si shumë e përfituar nga shitja e apartamentit në këtë vit, si dhe as ndryshimi i likuiditeteve dhe gjendjes *cash*.
- Subjekti, në deklaratën “Vetting” dhe në përgjigje të pyetësorit, nuk arriti të dokumentojë burimin e ligjshëm për vlerat e deklaruara të dhëna nga babai, nga vjehrrit dhe vlerën prej 8.800.000 lekësh të vjehrrës së tij.

- Subjekti nuk provoi kalimin e vlerës prej 8.800.000 lekësh, si përfitim nga shitja e kësaj pasurie në vitin 2012.
- Bazuar në dokumentacionin e administruar nga Komisioni rezulton se likuiditetet e vjehrrës dhe të vjehrrit së subjektit dhe pasuritë e zotëruara janë në një shumë të konsideruar dhe se subjekti nuk arriti të provonte burimin e ligjshëm të përfitimit të të ardhurave nga personat e tjerë të lidhur sipas ligjit nr. 84/2016.
- Bazuar në dokumentacionin e administruar nga Komisioni rezulton se likuiditetet e babait të subjektit (dhurimi në vlerën 1.000.000 lekë) dhe pasuritë e zotëruara (pasuria apartament në vlerën 4.300.000 lekë), janë në vlerën 5.300.000 lekë. Subjekti nuk provoi burimin e ligjshëm të përfitimit të të ardhurave nga babai si person tjetër i lidhur sipas ligjit nr. 84/2016.
- Nuk janë dokumentuar dhe provuar të ardhurat e babait të subjektit, si dhe mundësitë financiare në vlerën prej 1.000.000 lekësh dhuruar subjektit për blerjen e pasurisë apartament nga subjekti në vitin 2001, në raport kjo dhe me gjithë pasuritë dhe likuiditetet që disponon babai i subjektit.
- Të ardhurat e ligjshme të pretenduara të babait të subjektit, të vjehrrit dhe vjehrrës nuk janë të justifikuar në raport me burimet e ligjshme dhe mundësitë financiare për kontributin e tyre në pasurinë e blerë nga subjekti. Pra, personat e tjerë të lidhur kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për vlerat financiare të dhëna ndaj subjektit.
- Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, lidhur me të ardhurat nga qiratë e pretenduara të përfituara nga vjehrra dhe vjehrra, nuk provon dhe nuk mbulon burimin e ligjshëm të krijimit të tyre. Nga dokumentacioni i disponuar në dosjen e ILDKPKI, dërguar nga drejtoria e tatimeve, rezulton se për qiratë e përfituara nga vjehrra dhe vjehrra i subjektit, nuk janë paguar detyrimet tatimore përkatëse (tatim mbi fitimin).

Bazuar në analizën financiare rezultoi pamundësia e subjektit për blerjen e këtij apartamenti dhe kryerja e shpenzimeve të tjera në vlerën -4.592.074 lekë.

Në analizën financiare, të hartuar nga Komisioni, nuk ishte përfshirë vlera prej 1.000.000 lekësh, e deklaruar si shumë e marrë nga babai i subjektit, z. H.B., dhe as vlera prej 15.000 USD, e marrë nga vjehrra i tij, z. N.V., për arsye se subjekti nuk arriti të vërtetojë marrjen e tyre dhe as burimin e ligjshëm të tyre.

Në analizën financiare, gjithashtu, nuk ishin përfshirë të ardhurat nga shitja e apartamentit në Rr. “\*\*\*”, për arsye se subjekti nuk arriti të vërtetojë marrjen e këtyre shumave dhe nuk ka deklaruar as gjendjen e tyre në kursimet *cash* dhe as likuiditete si gjendje bankare atë vit. Gjithashtu, subjekti nuk arriti të vërtetojë burimin e ligjshëm të çmimit të blerjes prej 8.800,000 lekësh të paguara nga vjehrra e subjektit, znj. L.V.

Subjekti, për gjetjet dhe konstatimet e mësipërme, iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimet e bëra nga Komision, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

#### **Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka paraqitur dhe deklaruar:**

- *Të ardhurat e babait nga emigracioni për periudhën 1993-1996 kanë qenë në vlerën prej 16.000.000 lekë. Subjekti nuk disponon dokumentacion për të vërtetuar dhe dokumentuar këto të ardhura. Nga këto të ardhura shuma prej 1.000.000 lekë i është dhënë subjektit, shuma prej 4.300.000 lekë është blerë pasuria në posedim të subjektit, rreth 5.000.000 lekë janë depozita bankare në “ProCredit Bank” dhe vlera 5.000.000 lekë depozitë në “Raiffeisen Bank”.*
- *Burim krijimi për blerjen e kësaj pasurie nuk kanë qenë të ardhurat e krijuara nga dhurimi i vjehrrit. Në deklaratën periodike të vitit 2004 ka pasur një pasaktësi (gabim, lapsus pa*



*pasoja ligjore) lidhur me këtë dhurim. Dhurimi i shumës prej 15.000 USD nga vjehri është bërë por këto para janë mbajtur cash dhe janë përdorur më pas. Të ardhurat nga pensioni i vjehrit dhe vjehrrën deri në vitin 2002, të deklaruar nga subjekti kanë qenë në vlerën prej 1.053.516 lekësh.*

- *Kontrata e shitjes së bërë ndaj vjehrrës, znj. L.V., nuk ka qenë kontratë fiktive, por është një kontratë e hartuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Vjehrra e subjektit ka pasur mundësitë financiare për blerjen e pasurisë, pasi ka përfituar të ardhura nga dhënia me qira e pasurive në pronësi. Për këto të ardhura janë paguar detyrimet përkatëse, lidhur me tatimin mbi të ardhurat. Lidhur me vërtetimin e të ardhurave subjekti ka paraqitur dokumentacion të lëshuar nga drejtoria përkatëse e tatim taksave. Sipas këtij vërtetimi nuk përcaktohet qartë shuma e paguar sipas kontratave përkatëse të lidhur nga vjehri dhe vjehrra e subjektit (për këtë kërkohet një vendimmarrje e trupës me qëllim finalizim e analizës financiare).*
- *Subjekti, lidhur me pasurinë ku banon aktualisht, ka deklaruar se këtë pasuri e kam deklaruar si adresë banimi dhe nuk ka pasur detyrim ta deklarojë këtë pasuri dhe burimin e krijimit në deklaratën “Vetting”. Babai i subjektit nuk është person i lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Lidhur me burimin e blerjes së kësaj pasurie subjekti ka deklaruar se kanë qenë nga të ardhurat e përfituara nga emigracioni në vitet 1993-1996.*
- *Subjekti, lidhur me mosdeklarimin në deklaratat periodike vjetore të gjendjes së likuiditeteve të krijuara nga të ardhurat e shitjes së kësaj pasurie, ka deklaruar se nuk ka pasur detyrim ligjor për të deklaruar këto likuiditete dhe gjendjen e tyre cash në fund të vitit.*

#### **Trupi gjykues konstaton se:**

Subjekti nuk arriti të paraqesë prova dhe shpjegime bindëse për të provuar të kundërtën e gjetjeve të konstatuara nga Komisioni, ose të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së krijuar.

Rezultoi se të ardhurat e vjehrit të subjektit nga qiratë, për periudhën 2003 – 2004, kanë qenë në vlerën 2.280.361 lekë. Kjo shumë nuk është e mjaftueshme për të mbuluar investimet në *bono thesari* të bërë nga znj. L.V., (në vlerën 1.000.000 lekë – 2004), investimin e pretenduar të të ndjerit N.V., (në vlerën 1.500.000 lekë – 2004), si dhe dhurimin e pretenduar ndaj subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, në vlerën 15.000 USD ( 2.226.450 lekë).

Ndërkohë, në analizën financiare, Komisioni mori në konsideratë parashtrimet e subjektit lidhur me të ardhurat e tij si hetues në Prokurorinë e Rrethit Pogradec, si dhe pretendimin e tij për moslogaritje të shpenzimeve të jetesës për atë periudhë, meqë kishte trajtim të veçantë pranë hetuesisë.

Gjithashtu, Komisioni mori në shqyrtim edhe dokumentet shtesë të sjella nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes.

#### **Analiza e pasurisë apartament 1+1+garazh me sip. 70.8 m<sup>2</sup>+12.5 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”**

Të ardhura, A. Balliu, Gjykata e Rrethit Tiranë (Shtator 1994 - 2000) + Prokuroria Pogradec (1991-1993)	1 926 001
Të ardhura, R.B., (shtator 1999 - 2000)	283 877
<b>Totali i burimeve</b>	<b>2 209 878</b>
Shpenzime jetese, R.B., (shtator 1999 - qershor 2001)	178 466
Shpenzime jetese, Arjan Balliu ( 1994 - qershor 2001)	766 009
Shpenzime jetese, B.B., (shkurt 2000 - qershor 2001)	149 466
Ap. 1+1+ garazh 70.8 m <sup>2</sup> +12.5 m <sup>2</sup> , Rr. “****”, Tiranë - 2001 - 28.000 USD – 100 %	4 156 040

Shpenzime arredimi apartamenti, Rr. “****”, p. 50/1	100 000
<b>Total shpenzime</b>	<b>5 349 981</b>
<b>Pamundësia financiare për blerjen e apartamentit/shpenzime jetese/ arredimi</b>	<b>-3 140 103</b>

Bazuar në analizën financiare rezultoi se subjekti ka pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2001 në vlerën prej -3.140.103 lekë.

#### **Në përfundim konstatohet se:**

- Për këtë pasuri është bërë deklaram i pasaktë dhe i rremë lidhur me burimin e krijimit dhe se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.
- Për këtë pasuri, subjekti ka bërë kontratë fiktive për shitjen e kësaj pasurie te vjehrra e tij dhe se ajo ka rezultuar në mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e pasurisë në pronësi të tij.
- Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” pasurinë apartament me nr. \*\*\* (pasuri në pronësi të babait), që ka në përdorim dhe zotërim që nga viti 2012, ka kryer fshehje të kësaj pasurie, si dhe nuk arriti të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

**2. Apartament 1+1** me sip. 70 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z.k. \*\*\*, me adresë: Rr. “\*\*\*\*”, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 17.12.2015, në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 22.10.2007, në vlerën 2.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit, me licencë nr. \*\*\* dhe me NIPT \*\*\*.

#### **Konstatimi i ILDKPKI-së:**

- Subjekti ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor dhe burimi të ligjshëm financiar për blerjen e apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë në vitin 2007, në vlerën 2.000.000 lekë.
- Deklarim i rremë dhe kontratë fiktive për blerjen e apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”/ “\*\*\*\*”, Tiranë në vitin 2007, në vlerën 2.000.000 lekë, me qëllim fshehjen e burimit real dhe shmangien e detyrimeve tatimore ndaj shtetit, pasi vlera është nën koston e ndërtimit dhe nën vlerën e tregut për periudhën në zonën ku ndodhet apartamenti, zonë e cila është nga më të shtrenjtat në Tiranë.
- Deklarim i rremë në lidhje me vlerën e apartamentit në Rr. “\*\*\*\*”/ “\*\*\*\*”, Tiranë, në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës në vitin 2009, pasi është deklaruar në vlerën 2.900.000 lekë.
- Fshehje të apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”/ “\*\*\*\*”, Tiranë, nga bashkëshortja e subjektit (subjekt deklarues) në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2007.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Rezultoi se me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 17.12.2015, subjekti i rivlerësimit ka blerë pasurinë apartament me sip. 70 m<sup>2</sup>, me palë shitëse shoqërinë “P.G.”, e përfaqësuar me prokurë nga shtetasi A.Gj. Vlera e pasurisë sipas kontratës është 2.000.000 lekë. Për këtë pasuri subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratë sipërmarrjeje në datën 22.10.2007 (sip. apartamenti 79.26 m<sup>2</sup>), në vlerën prej 2.000.000 lekësh, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Për likuidimin e kësaj shume rezulton një mandatarkëtimi në datën 22.10.2007, në vlerën 2.000.000 lekë. Në deklaratën vjetore para fillimit të detyrës për vitin 2009 subjekti ka deklaruar vlerën e blerjes së kësaj pasurie në shumën 2.900.000 lekë. Bashkëshortja e subjektit,

si deklaruese më vete në ILDKPKI, nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2007 blerjen e kësaj pasurie.

Referuar Udhëzimit Nr. 2 të Këshillit të Ministrave, datë 4.4.2007, “Për miratimin e koston së ndërtimit.....”, rezulton se kostoja e ndërtimit për qytetin e Tiranës është në vlerën 29.914 lekë/m<sup>2</sup>, kurse kostoja mesatare e shitblerjes në tregun e lirë për vitin 2007 është në vlerën 97.000 lekë. Sipas deklaramit të subjektit çmimi i blerjes rezulton në vlerën 28.571 lekë/m<sup>2</sup>, pra, nën koston e ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave dhe shumë herë më pak se kostoja mesatare e shitblerjeve në tregun e lirë.

Gjithashtu, Komisioni ka kërkuar kontrata të ngjashme të shitblerjeve të pasurive të paluajtshme dhe ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. \*\*\*, datë 2.5.2019, ka dërguar të gjitha kontratat e shitblerjeve për këtë objekt. Sipas kontratave të ngjashme çmimet e shitjeve në këtë objekt për pasuritë apartament me sip. deri në 70 m<sup>2</sup>, figurojnë nga 30.000 USD, deri në 106.800 euro.

Komisioni, përveç gjetjeve të konstatuar nga ILDKPKI-ja për këtë pasuri, konstatoi edhe problematika të tjera, si më poshtë vijon:

- Vlera e blerjes së kësaj pasurie është nën vlerat e tregut dhe duket që vlera e shitjes së kësaj pasurie është me çmim preferencial, ose nuk është deklaruar vlera e saktë për blerjen e kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit.
- Nuk është deklaruar vlera e saktë, pasi në deklaratën “Vetting” vlera e kësaj pasurie është deklaruar në shumën 2.000.000 lekë, ndërkohë që në deklaratën periodike për vitin 2009 është deklaruar vlera prej 2.900.000 lekësh.
- Nuk vërtetohet dhe dokumentohet burimi i ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie. Sipas deklaramit në deklaratën “Vetting” burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat nga ushtrimi i funksionit të avokatit. Ka rezultuar se subjekti është regjistruar për ushtrimin e funksionit të avokatit në datën 10.10.2007 dhe pasurinë e ka blerë disa ditë pas regjistrimit në datën 22.10.2007. Nuk rezultojnë të ardhura të ligjshme gjatë kësaj periudhe të përfituara nga subjekti në shumën 2.000.000, pa përfshirë edhe vlerën e arredimit prej 900.000 lekësh, të deklaruar në përgjigje të pyetësorit. Bazuar në konfirmimin e drejtorisë së tatim-taksave për të gjithë vitin 2007, nuk rezultojnë të ardhura të ligjshme nga ushtrimi i funksionit të avokatit, si dhe as pagimi i detyrimeve ligjore për të gjithë këtë vit buxhetor.
- Gjithashtu, ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit ka pasur në shqyrtim çështjen civile nr. \*\*\* akti, ku shoqëria “P.G.” sh.p.k., ishte palë. Ajo ka dhënë dorëheqjen, duke mos marrë pjesë në këtë gjykim, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka pasur një kontratë sipërmarrjeje me këtë shoqëri. Në një rrethanë të ngjashme rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesues në çështjen penale në Gjykatën e Apelit Durrës, ku shtetasi A.Gj., (ortak dhe administrator i shoqërisë “A.B.”, personi i cili ka lidhur kontratën e porosisë me subjektin e rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie si dhe likuidues i shoqërisë “P.G.”), ka qenë palë e akuzuar dhe subjekti nuk rezulton të ketë paraqitur dorëheqjen nga kjo çështje. Akuza për shtetasin A.Gj., ka qenë ndërtim i paligjshëm dhe vendimi i Gjykatës së Apelit, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë relator i çështjes, ka qenë në favor të shtetasit A.Gj. Pra, në dukje, subjekti ka qenë në konflikt interesi për të shqyrtuar si relator çështjen penale në ngarkim të shtetasit A.Gj., i cili ka qenë palë shitëse në kontratën e lidhur për blerjen e pasurisë në vlerën preferenciale prej 2.000.000 lekësh.
- Në deklaratën periodike vjetore para fillimit të detyrës për vitin 2009, subjekti ka deklaruar vlerën e blerjes së kësaj pasurie në shumën 2.900.000 lekë. Bashkëshortja e subjektit, si deklaruese më vete, nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2007 blerjen

e kësaj pasurie. Gjithashtu, në deklaratën periodike vjetore për vitin 2009 subjekti nuk ka deklaruar më vete vlerën e pasurisë së blerë në shumën 2.000.000 lekë, si dhe shpenzimet e mëvonshme të kryera për këtë pasuri në shumën 900.000 lekë, duke mos deklaruar saktë vlerën e kësaj pasurie.

- Referuar Udhëzimit Nr. 2 të Këshillit të Ministrave, datë 4.4.2007, “Për miratimin e koston së ndërtimit.....”, rezultoi se kostoja e ndërtimit për qytetin e Tiranës është në vlerën 29.914 lekë për m<sup>2</sup> (dhe në vlerën e kësaj kostoje nuk përfshihen disa zëra të tjerë, siç janë projekti, vlera e truallit, etj., të cilat do rrisnin ndjeshëm vlerën e koston së ndërtimit), kurse kostoja mesatare e shitblerjes në tregun e lirë për vitin 2007 është në vlerën 97.000 lekë. Sipas deklaratimit të subjektit, çmimi i blerjes së kësaj pasurie rezultoi në vlerën 28.571 lekë për m<sup>2</sup>, pra, nën koston e ndërtimit të EKB-së dhe shumë herë më pak se kostoja mesatare e shitblerjeve. ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. \*\*\*, datë 2.5.2019, ka dërguar kontratat e shitblerjeve të pasurive apartament në këtë objekt. Sipas kontratave të ngjashme çmimet e shitjeve në këtë objekt, për pasuritë apartament me sip. deri në 70 m<sup>2</sup>, rezultojnë më të larta se vlera e deklaruar nga subjekti për blerjen e kësaj pasurie<sup>1</sup>.

Bazuar në analizën financiare, rezultoi se subjekti ka pasur pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie, në vlerën -2.000.000 lekë.

Gjithashtu, në analizën financiare nuk janë përfshirë nga Komisioni të ardhurat e deklaruar nga subjekti si burim për blerjen e pasurisë, meqenëse nuk vërtetohen nga organet tatimore të ardhura të krijuara si fitim neto nga ky aktivitet i avokatisë, për të cilat janë paguar edhe detyrimet tatimore.

Për konstatimet e mësipërme subjektit iu kalua barra e provës, për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me gjetjet e bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

#### **Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka paraqitur dhe deklaruar:**

- *Vlera për përfitimin e kësaj pasurie ka burim të ligjshëm nga të ardhurat e krijuara nga profesioni i avokatit dhe për këtë janë paguar detyrimet tatimore.*
- *Pranë Bashkisë Tiranë janë paguar detyrimet lidhur me këtë aktivitet.*
- *Lidhur me përfaqësimin e shoqërisë “P.G.,” në proceset gjyqësore, nuk mund të përcaktohet dhe dokumentohet shuma e saktë, pasi konsultat, ndihma juridike dhe përfaqësimet gjyqësore janë bërë në vazhdimësi dhe në kushtet e mirëbesimit dhe të konfidencialitetit.*
- *Lidhur me vlerën prej 2.000.000 lekësh të blerjes së kësaj pasurie, subjekti sqaron se meqenëse shoqëria “P.G.,” ka qenë në vështirësi financiare për të kryer pagesa tek të tretët dhe se përfaqësonte këtë shoqëri në procese gjyqësore dhe nuk ishte shpërblyer për punën e kryer, i është ofruar marrëveshje për të marrë apartament.*
- *Duke qenë se kjo pasuri është ndërtuar në vitet 2001 - 2003, kostoja e ndërtimit për këtë periudhë është në vlerën 28.749 lekë/m<sup>2</sup>. Nëse i referohemi udhëzimit për vlerën në tregun e lirë, atëherë çmimi për m<sup>2</sup> rezultoi 97.000 lekë dhe se asnjë apartament nuk është shitur në këtë vlerë.*
- *Nuk ka trajtim preferencial, pasi në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes subjekti nuk ka qenë në funksion zyrtar.*
- *Nuk ka deklarim të rremë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 (ku është deklaruar vlera e blerjes 2.900.000 lekë), pasi këtu është përfshirë edhe vlera e shpenzimeve si investime shtesë dhe arredim (shuma 900.000 lekë).*

---

<sup>1</sup> Shikoni përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë, në dosjen e Komisionit.

- Në deklaratën “Vetting” është vendosur vlera e blerjes në shumën 2.000.000 lekë, pasi nuk ka ndonjë rubrikë të veçantë për investimin shtesë të kryer në këtë deklaratë.
- Kjo pasuri është krijuar nga të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortja nuk ka pasur detyrim ligjor për ta deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2007.
- Nuk ka konflikt interesi me personin A.Gj., i cili ka qenë përfaqësues i shoqërisë “P. G.,” për lidhjen e kontratës së sipërmarrjes për këtë pasuri në vitin 2007. Të gjitha detyrimet ndaj kësaj shoqërie subjekti i ka likuiduar në vitin 2007 dhe çështja gjyqësore penale që ka pasur me këtë person ka qenë në vitin 2016 (kontrata e shitjes është bërë në datën 17.12.2015, ku z. A.Gj., ka qenë pala e autorizuar për shitjen e kësaj pasurie subjektit).

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti nuk arriti të paraqesë prova dhe shpjegime bindëse për të provuar të kundërtën e gjetjeve të konstatuara nga Komisioni dhe as të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së krijuar.

Për llogaritjen e fitimit nga aktiviteti i avokatisë për subjektin e rivlerësimit, Komisioni mori në konsideratë provat e paraqitura nga subjekti që vërtetonin pagesën e detyrimeve tatimore për tremujorin e fundit të vitit 2007. Bazuar në këtë vërtetim, Komisioni ka llogaritur fitimin e mundshëm, bazuar në vlerën e qarkullimit maksimal të këtij tremujori dhe normës më të madhe të fitimit të realizuar në vitet 2008 - 2009. Qarkullimi maksimal është marrë në vlerën 3.000.000 lekë, sipas deklaratimit të vetë subjektit dhe pagesës së taksës të kryer si biznes i vogël me xhiro nga 2.000.000 lekë deri në 3.000.000 lekë. Norma e fitimit është llogaritur bazuar në fitimin e realizuar për vitet 2008 - 2009, e cila nuk e kalon masën 50 %.

Llogaritja është bërë si më poshtë:  $3.000.000 * 3/12 * 50 \% = 375.000$  lekë.

Sipas kësaj llogaritjeje rezultoi se fitimi i mundshëm për vitin 2007 nga ky aktivitet është në vlerën 375.000 lekë. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi dhe burime të mjaftueshme financiare për blerjen e kësaj pasurie në vlerën 1.625.000 lekë.

#### **Analiza e pasurisë apartament 1+1, me sip. 70 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”**

Të ardhura të dokumentuara nga avokatia për periudhën 10.10.2007 – 22.10.2007	375,000 lekë
Blerë apartament 1+1, me sip. 70 m <sup>2</sup> , Rr. “****”, Tiranë, viti 2007	2,000,000 lekë
<b>Pamundësia financiare për blerjen e apartamentit, Rr. “****”</b>	<b>-1,625,000 lekë</b>

Bazuar në analizën financiare, rezultoi se subjekti ka pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2007, në vlerën -1.625.000 lekë.

#### **Në përfundim konstatohet se:**

- Për këtë pasuri është bërë deklaram i pasaktë lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie.
- Rezultoi se subjekti e ka blerë këtë pasuri nën çmimet e tregut dhe nuk arriti të provonte dhe dokumentonte shërbimet që ka kryer si avokat ndaj shoqërisë shitëse, të ardhurat përkatëse të përfituara, si dhe as pagimin e detyrimeve tatimore lidhur me këto të ardhura të pretenduara.
- Me personin me të cilin ka lidhur kontratën e sipërmarrjes dhe më pas të shitjes në vitin 2015 për këtë pasuri, subjekti ka qenë në konflikt interesi dhe trupi gjykues çmon se nuk duhet të ndiqte çështjen gjyqësore penale në vitin 2016 ndaj shtetasit A.Gj.

**3. Apartament banimi 2+1, me sip. 74.8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z.k. \*\*\*, ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, blerë nga privatizimi i banesave shtetërore me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 19.10.1993, në vlerën 24.374 lekë. Pjesa takuese: 1/3.**

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: nga kursimet e prindërve.

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Rezultoi se në datën 23.7.1993, sipas formularit nr. 3 të kontratës dhe sipas kontratës së shitblerjes datë 30.9.1993, ky apartament është blerë në vlerën 24.374 lekë nga Ndërmarrja Komunale Banesa prej babait të subjektit. Në kontratën e shitblerjes rezultojnë katër bashkëpronarë.

Subjekti, për këtë pasuri, është pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie në datën 1.11.2011, ku rezultojnë tre bashkëpronarë për këtë pasuri të paluajtshme.

Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti edhe në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009, me përshkrimin: *apartament 2+1, me sip. 74.8 m<sup>2</sup>, Rr. "\*\*\*\*", p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, në vlerën 24.374 lekë. Pjesa takuese: 1/4.*

Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 subjekti ka deklaruar se me marrjen e certifikatës së pronësisë është konstatuar se nuk ishte pasqyruar emri i vëllait D. B., si dhe pjesa e tij takuese në këtë pasuri. Ky regjistrim është korrigjuar nga ZVRPP-ja dhe bazuar në dokumentin zyrtar është bërë deklarimi i pjesës takuese prej 1/3.

#### **Në përfundim konstatohet se:**

Komisioni nuk ka ngritur dyshime të mëtejshme për këtë pasuri, pasi kjo pasuri është krijuar nga prindërit e subjektit të rivlerësimit me anë të procedurës së privatizimit në vitin 1993, para fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit.

**4. Automjet tip "Audi A3"**, me targa AA \*\*\*, blerë me kontratën e shitjes datë 8.11.2012, me vlerë 25.000 euro. Pjesa takuese: 100 %.

Burimi i krijimit sipas deklaratës "Vetting": kursimet nga paga dhe të ardhura të përfituara nga shitja e apartamentit 1+1, me sip. 70.8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z.k. \*\*\*, Rr. "\*\*\*\*", p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë.

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR-së.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Në datën 8.11.2012 rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratë shitblerjeje automjeti me shoqërinë "P.A". Objekti i kontratës është blerja e një automjeti në vlerën 25.000 euro, e cila do të likuidohet tërësisht nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e automjetit. Rezultoi se likuidimi është bërë i plotë dhe i menjëhershëm nga subjekti te shoqëria shitëse e automjetit.

Në përfundim të hetimit për këtë pasuri Komisioni konstatoi se:

- Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe vlerën e blerjes së këtij automjeti.
- Lidhur me burimin e ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie subjekti nuk ka deklaruar ose dokumentuar se sa kanë qenë të ardhurat nga paga dhe sa kanë qenë të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurisë apartament.
- Kontrata e shitjes së apartamentit, i cili përbën burimin e ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie, është konstatuar nga Komisioni si kontratë fiktive, pasi nuk janë dokumentuar të ardhurat e ligjshme të vjehrrës së subjektit për blerjen e pasurisë apartament. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk dispononte burime të ligjshme financiare për blerjen e pasurisë automjet.

Bazuar në analizën financiare rezultoi se subjekti ka pasur pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2012, në vlerën -2.508.807 lekë.

Në analizën financiare të hartuar nga Komisioni nuk është përfshirë burimi i deklaruar nga subjekti, të ardhura nga shitja e apartamentit në Rr. “\*\*\*\*” për blerjen e automjetit në fjalë. Të ardhurat e ligjshme të përfituara nga shitja e apartamentit nuk janë provuar nga subjekti dhe rrjedhimisht nuk mund të konsiderohen si burim i ligjshëm për blerjen e një pasurie tjetër.

Subjektit, për gjetjet dhe konstatimet e mësipërme, iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimet e bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

#### **Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka paraqitur dhe deklaruar:**

- *Të ardhurat nga paga për blerjen e kësaj pasurie kanë qenë në vlerën 200.000 lekë dhe pjesa tjetër nga të ardhurat e shitjes së pasurisë me vlerë 8.800.000 lekë.*
- *Të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë apartament janë mbajtur cash dhe nuk ka pasur detyrimin të deklarojë gjendjen cash në banesë për këtë periudhë.*

#### **Analiza e pasurisë, automjet tip “Audi A3”, me targa AA \*\*\*, viti 2012**

Të ardhura nga shitja e apartamentit, Rr. “****”	0
Te ardhurat nga pagat deklaruar nga subjekti	200 000
<b>Totali i burimeve</b>	<b>200 000</b>
Automjet tip “Audi A3”, me targa AA ***, datë 8.11.2012, në vlerën 25.000 euro	3 495 750
<b>Pamundësia financiare për blerjen e automjetit tip “Audi A3” dhe shpenzime të tjera</b>	<b>-3 295 750</b>

Bazuar në analizën financiare rezultoi se subjekti ka pasur pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2012, në vlerën -3.295.750 lekë.

#### **Në përfundim konstatohet se:**

Komisioni, për këtë pasuri, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk arriti të paraqesë prova dhe dokumentacion justifikues për të provuar të kundërtën e gjetjeve të konstatuara prej tij.

**5. Bono thesari**, për periudhën 24.6.2004 – 24.12.2007, në vlerën 3.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: shuma prej 1.500.000 lekësh janë kursime nga të ardhurat familjare dhe 1.500.000 lekë të depozituara nga subjekti për ish-vjehrrin, z. N.V., (për pamundësi fizike).

#### **Konstatimi i ILDKPKI-së:**

- Subjekti ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor dhe burimi të ligjshëm financiar lidhur me të ardhurat e vjehrrit, z. N.V., që kanë shërbyer për blerje bono thesari në vlerën 1.500.000 lekë.
- Fshehje e destinacionit të përdorimit të shumës 2.500.000 lekë në vitin 2007 nga bashkëshortja e subjektit (subjekt deklarues).

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Banka e Shqipërisë, më anë të vërtetimit të ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së, ka konfirmuar gjendjen e likuiditetit të krijuar nga subjekti që prej datës 24.6.2004, në vlerën 3.000.000 lekë. Kjo shumë ka rezultuar e tërhequr nga subjekti në datën 24.14.2007. Hapja e kësaj llogarie bankare dhe depozitimi i shumës prej 3.000.000 lekësh është bërë vetëm në emër të subjektit të rivlerësimit dhe prej tij nuk disponohet aktperfaqësimi i vjehrrit. Ky likuiditet nuk rezulton i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2009 dhe as në deklaratat periodike vjetore në vijim.

Në deklaratën “Vetting” subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie dhe nuk arriti të provojë burimin e krijimit të shumës 1.500.000 lekë nga vjehri i tij dhe mundësitë financiare të vjehrrit për krijimin e kësaj shume.

Në përfundim të hetimit për këtë pasuri Komisioni konstatoi se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën fillestare të vitit 2009 dhe as në deklaratat periodike në vitet në vijim.
- Kjo pasuri nuk figuroi në emër të vjehrrit të subjektit dhe deklarimi i bërë se gjysma e këtij likuiditeti është depozitim i z. N.V., nuk u provua nga subjekti.
- Nuk është provuar edhe fakti i burimit të ligjshëm të personit të lidhur, siç është vjehri i subjektit lidhur me shumën 1.500.000 lekë, në raport kjo dhe me pasuritë e ligjshme dhe likuiditetet që dispononte në periudhën e pretenduar për krijimin e kësaj vlere financiare.

Bazuar në analizën financiare rezultoi se subjekti ka pasur pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2004, në vlerën -2.705.114 lekë.

Në analizën financiare të hartuar nga Komisioni nuk është marrë parasysh detyrimi/dhurimi në vlerën 1.500.000 lekë, që subjekti i rivlerësimit pretendon se ia ka dhënë vjehri z. N.V., për investim në bono thesari, sepse nga subjekti nuk është dokumentuar marrja e tyre dhe nuk vërtetohet as burimi i ligjshëm i këtyre vlerave financiare.

Subjektit, për konstatimet e mësipërme, iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me gjetjet e bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

#### **Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka paraqitur dhe deklaruar:**

- *Nga kjo pasuri, gjysma e saj është pasuri e subjektit dhe gjysma tjetër është pasuri e vjehrrit.*
- *Vlera prej 1.500.00 lekësh, që ka shërbyer për blerje bono thesari, ka pasur si burim të ligjshëm të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e pronave prej vjehrrit ndërsa vlera 2.450 USD nga zbatimi i një vendimi gjyqësor datë 24.1.2002.*
- *Kjo shumë, pas tërheqjes nga banka, i është kthyer vjehrrit të subjektit.*
- *Nuk është deklaruar veprimi, shuma dhe tërheqja e saj në deklaratën periodike për vitin 2007 nga bashkëshortja, për shkak të një paqartësie dhe harrese.*
- *ILDKPKI-ja ka verifikuar të gjitha deklaratat periodike dhe nuk ka konstatuar dhe nuk ka marrë asnjë masë disiplinore.*

#### **Analiza e pasurisë bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë në vlerën -3.000.000 lekë, viti 2004**

Të ardhura të dokumentuara janar – 1/2 qershor 2004	435 832
Shpenzime jetese (6 muaj 2004)	140 946
Blerë bono thesari, datë 24.6.2004	3 000 000



Bazuar në analizën financiare rezultoi se subjekti ka pasur pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2004, në vlerën prej -2.705.114 lekë.

Komisioni, për këtë pasuri, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të paraqesë prova dhe dokumentacion justifikues për të provuar të kundërtën e gjetjeve të konstatuara prej tij.

**6. Llogari bankare me nr. \*\*\* në “Raiffeisen Bank”, me vlerë 550.375 lekë. Pjesa takuese: 1/2.**

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhura nga pagat dhe shitja e pasurisë së paluajtshme me kontratën nr. \*\*\*, datë 7.4.2012, të apartamentit 1+1+aneks, me sip. 70.8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z.k. \*\*\*, Tiranë.

#### **Konstatimi i ILDKPKI-së:**

- Për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie nga shitja e apartamentit me sip. 70.8 m<sup>2</sup> nënës së bashkëshortes, është trajtuar në këtë raport.
- Pasaktësi në deklaratimet e interesave private periodike vjetore 2013 – 2016, lidhur me gjendjen e likuiditeteve (në sistemin bankar/cash).

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Sipas ekstraktit të llogarisë së “Raiffeisen Bank” të ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së, rezulton se kjo llogari është në emrin e subjektit nga i cili në deklaratën “Vetting” nuk është paraqitur dokumentacion justifikues që provon se ky likuiditet është krijuar nga paga dhe shitja e apartamentit në Tiranë.

Gjithashtu, subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën Vetting” se sa kanë qenë të ardhurat nga paga dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit, për të provuar burimin e krijimit të këtij likuiditeti.

Në deklaratat periodike vjetore të paraqitura në ILDKPKI nuk janë paraqitur deklarime, të cilat provojnë pretendimet e subjektit për burimin e krijimit të këtij likuiditeti.

Subjektit, për gjetjet dhe konstatimet e mësipërme, iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimet e bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni, për këtë pasuri, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të paraqesë prova dhe dokumentacion justifikues për të provuar të kundërtën e gjetjeve të konstatuara prej tij.

**7. Gjendje në vlerën 1.000.000 lekë, cash, në banesë. Pjesa takuese: 1/2.**

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: kursime familjare dhe të ardhura të përfituara nga shitja e pasurisë së paluajtshme me kontratën nr. \*\*\*, datë 7.4.2012, të apartamentit 1+1+aneks, me sip. 70.8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z.k. \*\*\*, Tiranë.

#### **Konstatimi i ILDKPKI-së:**

- Për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie nga shitja e apartamentit me sip. 70.8 m<sup>2</sup> nënës së bashkëshortes, është trajtuar në këtë raport.

- Pasaktësi në deklaratimet e interesave private periodike vjetore 2013 – 2016, lidhur me gjendjen e likuiditeteve (në sistemin bankar/cash).

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Rezultoi se nga viti 2015 subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në deklaratat periodike vjetore të deklaratimit të pasurisë, të dorëzuara në ILDKPKI.

Për këtë pasuri nga Komisioni janë evidentuar të njëjta gjetje të bëra nga ILDKPKI-ja, duke konstatuar edhe se subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në deklaratën periodike vjetore për vitet 2012 dhe 2013. Gjithashtu, edhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me gjendjen *cash* të krijuar ndër vite nga subjekti janë kontradiktore.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë gjendje *cash* në banesë në deklaratën periodike për vitin 2014, në vlerën 200.000 lekë. Ndërsa, në deklaratën periodike të vitit pasardhës 2015, ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash*, në vlerën 700.000 lekë, në banesë.

Subjektit, për gjetjet dhe konstatimet e mësipërme, iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimet e bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni, për këtë pasuri, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës nuk arriti të paraqesë prova dhe dokumentacion justifikues për të provuar të kundërtën e gjetjeve të konstatuara nga Komisioni.

**8. Apartament me sip. 123 m<sup>2</sup>**, me nr. pasurie \*\*\*, z.k. \*\*\*, ndodhur në \*\*\*, Kavajë, sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 26.11.2007, dhe kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., datë 13.1.2004, si dhe kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., datë 30.10.2004. Vlera: 4.500.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Burim i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: përfituar nga nëna e bashkëshortes së subjektit, znj. Lejla Vigani, si ish-pronare e truallit.

### **Konstatimi i ILDKPKI-së:**

- Deklarim i paqartë dhe dokumentacion jo i plotë lidhur me përfitimin e apartamentit me sip. 123 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Kavajë.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin e krijimit të shumës 4.500.000 lekë, nga nëna e bashkëshortes, znj. L.V., sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 26.11.2007.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Në datën 13.1.2004, me kontratën nr. \*\*\* rep., është lidhur kontrata e sipërmarrjes me firmën “A.”, nga disa bashkëpronarë ndër të cilët edhe vjehrra e subjektit, znj. L.V. Sipas kësaj kontrate, znj. L.V., zotëron një truall me sip. 600 m<sup>2</sup>, mbi të cilën do të ndërtohej një godinë banimi shumëkatëshe. Znj. L.V., do të përfitonte nga ndërtimi 26 % e të sipërfaqes totale ndërtimore.

Në datën 30.10.2004 bashkëshortja e subjektit ka lidhur një kontratë porosie me shoqërinë “A.”, në mbështetje të kontratës fillestare të datës 15.1.2004, ku do të përfitonte apartament banimi me sip. 118.5 m<sup>2</sup>.

Subjekti nuk kishte deklaruar pse është lidhur kjo kontratë sipërmarrjeje nga bashkëshortja e tij, e cila nuk kishte në pronësi truallin ku do të ndërtohej, pasi truall rezultonte në pronësi të nënës së saj.

Në datën 26.11.2007, me kontratën nr. \*\*\*, bashkëshortja e subjektit ka lidhur kontratë për blerje pasurie të paluajtshme nga shoqëria “S.J.K.”. Objekti i kontratës është blerja e një pasurie me sip. 123 m<sup>2</sup>, në \*\*\* Kavajë, në vlerën 4.500.000 lekë. Sipas kësaj kontrate kjo vlerë është likuiduar nga znj. L.V. Për këtë pasuri është lëshuar edhe certifikatë për vërtetim pronësie në datën 31.12.2007, vetëm në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

Në dosjen e ILDKPKI-së rezultoi edhe një deklaratë noteriale e datës 5.2.2009, ku znj. L. V., deklaroi se sipërfaqen ndërtimore, sipas marrëveshjes që kishte me shoqërinë “A.”, e ka marrë nga shoqëria “S.J.K.”, por për këtë fakt nuk ekziston asnjë dokumentacion tjetër shkresor.

Në përfundim të hetimit për këtë pasuri Komisioni konstatoi se:

- Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me këtë pasuri.
- Bazuar në kontratën e sipërmarrjes të datës 30.10.2004, të lidhur nga bashkëshortja e subjektit, ajo vepron e vetme si pronare e truallit, në kundërshtim me situatën ligjore të pronësisë.
- Rezultoi mungesë e dokumentacionit ligjor provues për blerjen e truallit dhe për burimin e ligjshëm të blerjes së tij.
- Nuk është dokumentuar nga subjekti i rivlerësimit se sa ka qenë përfitimi në total i pasurisë së paluajtshme “sipërfaqe ndërtimi”, i personit të lidhur L.V., në shoqëritë ndërtuese “A.” dhe “S.J.K.”.
- Bazuar në kontratën e shkëmbimit të truallit, vjehrra e subjektit duhet të përfitonte vetëm dy njësi ndërtimore nga shkëmbimi i truallit. Komisioni konstatoi se vjehrra e subjektit ka përfituar gjithsej katër njësi.
- Nuk u vërtetua se kjo pasuri është përfituar nga shkëmbimi i truallit, por sipas kontratës është përfituar me anë të blerjes në shumën 4.500.000 lekë. Vjehrra e subjektit të rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për shumën 4.500.000 lekë.
- Përfitimi i drejtpërdrejtë i kësaj pasurie nga bashkëshortja e subjektit duket se është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë marrëdhëniet për fitimin e pronësisë. Sipas përgjigjeve të pyetësorit është deklaruar se bashkëshortja e subjektit nuk ka qenë pronare e truallit ku është ndërtuar pasuria në fjalë, por nëna e saj. Kalimi i pronësisë së apartamentit direkt te bashkëshortja e subjektit është bërë në kundërshtim me dispozitat e Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi, si dhe me këto veprime të kryera janë shmangur detyrimet financiare përkatëse në buxhetin e shtetit.

Subjektit, për konstatimet e mësipërme, iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me gjetjet e bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

#### **Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka paraqitur dhe deklaruar se:**

- *Subjekti ka kundërshtuar konstatimin e bërë nga Komisioni për këtë pasuri.*
- *Nëna e bashkëshortes së subjektit ka qenë pronare e truallit dhe ka lidhur kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “A.”, më qëllim shkëmbimin e truallit me sipërfaqe ndërtimi. Nga ky shkëmbim do të përfitonte dy apartamente 1+1, me sip. 81.5 m<sup>2</sup>.*
- *Bashkëshortja e subjektit nuk ka qenë asnjëherë pronare e truallit, por me dëshirën e nënës së saj i është caktuar që në fillim pjesa e saj, e përfituar nga ndërtimi.*
- *Subjekti ndërtues “A.” ka lidhur kontratë nënsipërmarrjeje me shoqërinë “S.J.K.”.*
- *Në përfundim të procesit dhe ndërtimit, nëna e bashkëshortes ka përfituar katër pasuri me sip. 87.9 m<sup>2</sup>, 86.9 m<sup>2</sup>, 136.6 m<sup>2</sup> (apartamente) dhe garazh me sip. 18.2 m<sup>2</sup>.*

- Në mungesë absolute të parashikuar nga legjislacioni civil të përpilimit dhe nënshkrimit të kontratave të sipërmarrjes dhe dhurimit kemi zgjedhur si rrugë ligjore mënyrën e vetme të kalimit të pronësisë, kontratën e shitjes, e cila parashikohet nga neni 705, i Kodit Civil.

Komisioni, për këtë pasuri, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk arriti të paraqesë prova dhe dokumentacion justifikues për të provuar të kundërtën e gjetjeve të konstatuara prej tij.

**9. Njësi me sip. 151.20 m<sup>2</sup>**, me nr. pasurie \*\*\*, z.k. \*\*\*, e ndodhur në Rr.” \*\*\*\*”, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*. Durrës. Pjesa takuese: 1/3.

Burim i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: pasuri trashëgimore, nga dëshmia e trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 13.3.2014.

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ZVRPP-së Durrës.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Pas hetimit të kryer rezultoi se kjo pasuri është përfituar nga babai i bashkëshortes së subjektit me anë të vërtetimit të pronësisë datë 23.11.1992. Këtë pasuri bashkëshortja e subjektit, e cila zotëron 1/3 e saj, e ka përfituar me anë të trashëgimisë ligjore.

Kjo pasuri (objekt “lokal”) është dhënë me qira nga viti 2013 nga babai i bashkëshortes së subjektit dhe më pas nga bashkëshortja e subjektit, nëna dhe vëllai i saj. Për këtë pasuri nuk rezultoi se bashkëshortja e subjektit ka paguar tatimin mbi të ardhurat nga qiraja dhe këto të ardhura nuk janë përfshirë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare të hartuar nga Komisioni.

Subjektit, për konstatimet e mësipërme, iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me gjetjet e bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Pas përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit dhe provave shkresore të administruara, Komisioni vendosi të përfshijë në analizën financiare<sup>2</sup> të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e kësaj pasurie, për të cilën janë paguar detyrimet tatimore përkatëse.

**10. Apartament me sip. 92.75 m<sup>2</sup>**, me nr. pasurie \*\*\*, z.k. \*\*\*, i ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, Durrës. Pjesa takuese: 1/3.

Burim i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: pasuri trashëgimore, nga dëshmia e trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 13.3.2014.

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ZVRPP-së Durrës.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Për këtë pasuri rezultoi certifikata për vërtetim pronësie e datës 15.5.2014, në bashkëpronësi të shtetasve E.V., L.V., dhe R.B., (V.).

Për këtë pasuri është lëshuar dëshmi trashëgimie ligjore nr. \*\*\*, datë 13.3.2014, për z. N. V., ku shtetasit E.V., L.V., dhe R.B., (V.) caktohen trashëgimtarë ligjorë me nga 1/3.

#### **Në përfundim konstatohet se:**

Kjo pasuri është përfituar me anë të trashëgimisë ligjore dhe e krijuar përpara fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni nuk ka konstatuar problematika për këtë pasuri.

---

<sup>2</sup> Shikoni analizën financiare më poshtë në këtë vendim.

**11. Apartament me sip. 77 m<sup>2</sup>**, me nr. pasurie \*\*\*, z.k. \*\*\*, i ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, Durrës. Pjesa takuese: 1/3.

Burim i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: pasuri trashëgimore, nga dëshmia e trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 13.3.2014.

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ZVRPP-së Durrës.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Për këtë pasuri rezultoi certifikata për vërtetim pronësie e datës 15.5.2014, në bashkëpronësi të shtetasve E.V., L.V., dhe R.B., (V.).

Për këtë pasuri është lëshuar dëshmi trashëgimie ligjore nr. \*\*\*, datë 13.3.2014, për z. N. V., ku shtetasit E.V., L.V., dhe R.B., (V.) caktohen trashëgimtarë ligjorë me nga 1/3.

#### **Në përfundim konstatohet se:**

Kjo pasuri është përfituar me anë të trashëgimisë ligjore dhe e krijuar përpara fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni nuk ka konstatuar problematika për këtë pasuri.

**12. Llogari në “Credins Bank”, me vlerë 500.106 lekë.**

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhura nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 12.11.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas urdhrimit të ekzekutimit nr. \*\*\*, datë 27.3.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Pjesa takuese: 100 %.

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e “Credins Bank”.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Për sa i takon të ardhurave nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në analizën financiare të bërë nga Komisioni është përfshirë 1/3 e shumës që i ka kaluar znj. R.B., meqë kjo është pjesa që i takon asaj me ligj.  $1/3 * 652.190 = 217.397$  lekë.

Deklarimi i bërë për krijimin e shumës prej 500.106 lekësh nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, nuk rezultoi i saktë. Bazuar në vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 12.11.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas urdhrimit të ekzekutimit nr. \*\*\*, datë 27.3.2013, subjekte përfituese të shumës prej 1.956.570 lekë, kanë qenë shtetasit A.V., M.H., dhe N.V., (babai i bashkëshortes së subjektit). Pjesa përfituese e babait të bashkëshortes së subjektit, z. N.V., ka qenë në shumën 652.190 lekë, shumë e cila i kalon trashëgimtarëve të bashkëshortes së subjektit, nënës dhe vëllait të saj, përkatësisht nga 1/3 e shumës.

Subjektit, për konstatimet e mësipërme, iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me gjetjet e bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Pas përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit dhe provave shkresore të administruara, Komisioni vendosi të përfshijë në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga 1/3 e shumës takuese prej 652.190 lekësh, si pjesë përfituese e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, pasi subjekti nuk arriti të provojë dhe të dokumentojë të kundërtën.

**13. Automjet tip “Fiat Bravo”, me targa TR \*\*\*, me kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë. 14.9.1999, me vlerë 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.**

Burim i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhura nga paga dhe kursimet familjare.

**Konstatimi i ILDKPKI-së:**

Subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës 2003 automjetin tip “Fiat Bravo”, blerë nga bashkëshortja në vitin 1999, në vlerën 1.000.000 lekë. Automjeti është deklaruar nga znj. R.B., në të njëjtën periudhë deklarimi, pra viti 2003.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Rezultoi se bashkëshortja e subjektit, znj. R.B., ka blerë automjetin me targa TR \*\*\*, në datën 14.9.1999, në vlerën 1.000.000 lekë. Më pas, ky automjet është shitur në vitin 2014, në vlerën 100.000 lekë.

Bazuar në analizën financiare Komisioni nuk konstatoi problematikë për blerjen e kësaj pasurie dhe burimin e ligjshëm të krijimit.

Subjektit, për mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën fillestare të pasurisë për vitin 2003, iu kërkuan shpjegime në rezultatet e hetimit.

Pas përgjigjes së subjektit të rivlerësimit, Komisioni arriti në përfundim se subjekti ka bërë deklaram të saktë për këtë pasuri dhe se bashkëshortja e tij ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie me burime të ligjshme.

**14. Automjet tip “Peugeot”, me targa A \*\*\*, blerë me aktshitjeje datë 5.6.2014, me vlerë 205.860 lekë. Pjesa takuese: 100 %.**

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhura nga paga dhe shitja e automjetit tip “Fiat Bravo” me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 20.6.2014.

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR-së.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Rezultoi se bashkëshortja e subjektit, znj. R.B., në datën 5.6.2014 ka blerë automjetin tip “Peugeot”, në vlerën 205.860 lekë. Këtë automjet e ka shitur më pas në datën 30.9.2015, në vlerën 200.000 lekë.

Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të ardhurash për blerjen e kësaj pasurie shitjen e automjetit tip “Fiat”, me vlerë 100.000 lekë, ndërsa ky mjet është blerë në vlerën 205.860 lekë ndërsa pjesa tjetër konsiderohet se është përballuar nga të ardhurat e krijuara nga paga për vitin 2014.

Bazuar në analizën financiare Komisioni nuk konstatoi problematikë për blerjen e kësaj pasurie dhe burimin e ligjshëm të krijimit.

Komisioni, për këtë pasuri, arriti në përfundim se subjekti dhe bashkëshortja kanë bërë deklaram të saktë dhe se kanë pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie me burime të ligjshme.

**15. Automjet tip “Mercedez Benz” B 180 CDI, me targa AA \*\*\*, blerë me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 22.12.2015, me vlerë 700.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.**

Burim i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhura nga paga, kursimet dhe shitja e automjetit tip “Peugeot”, me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 30.9.2015.

**Konstatimi i ILDKPKI-së:** deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR-së.

Rezultoi se bashkëshortja e subjektit, znj. R.B., në datën 22.12.2015 ka blerë automjetin tip “Mercedez Benz”, në vlerën 700.000 lekë. Ky automjet disponohet edhe sot nga subjekti dhe nga bashkëshortja e tij.

Subjekti ka deklaruar si burim të ardhurash për blerjen e kësaj pasurie shitjen e automjetit tip “Peugeot”, me vlerë 200.000 lekë ndërsa pjesa tjetër është llogaritur nga të ardhurat nga paga dhe kursimet.

Bazuar në analizën financiare Komisioni nuk konstatoi problematikë për blerjen e kësaj pasurie dhe burimin e ligjshëm të krijimit.

Komisioni, për këtë pasuri, arriti në përfundimin se subjekti ka bërë deklaram të saktë dhe se ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie me burime të ligjshme.

## 16. Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit

### Konstatimi i ILDKPKI-së:

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për shlyerjen e detyrimeve tatimore ndaj shtetit për të ardhurat nga qiraja, shlyerje të cilat nuk konfirmohen as nga organet tatimore.
- Subjekti ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti privat si avokat në vlerën 5.650.000 lekë, ndërsa organet tatimore konfirmojnë fitim në vlerën 1.550.000 lekë.
- Subjekti ka ushtruar funksionin në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka filluar detyrë si inspektor në KLD në datën 22.9.2009. Sipas konfirmimeve të QKB-së dhe organet tatimore, aktiviteti privat si avokat rezulton me status pasiv prej datës 29.10.2012 dhe çregjistruar prej datës 19.9.2015. Gjithashtu, subjekti ka dorëzuar në sistemin tatimor deklaratat e “tatim mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël” për periudhën 2008, 2009, 2010. Bashkia Tiranë konfirmon status të “mbyllur” në datën 10.3.2010.

Këto gjetje të ILDKPKI-së iu kaluan subjektit të rivlerësimit si barrë prove në rezultatet e hetimit, për të provuar të kundërtën e tyre.

Komisioni, pas përgjigjes së subjektit të rivlerësimit, arriti në përfundim se:

- Të ardhurat e llogaritura në analizën financiare nga dhënia e pasurive me qira, bazohen në ato të ardhura të dokumentuara dhe për të cilat janë paguar të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- Të ardhurat e llogaritura në analizën financiare nga ushtrimi i aktivitetit privat si avokat, bazohen në ato të ardhura të dokumentuara nga institucionet shtetërore dhe për të cilat janë paguar të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi.
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka rezultuar në situatën e konfliktit të interesit, pas fillimit të detyrës si inspektor pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

### Analiza financiare

#### Subjekti i rivlerësimit, z. Arjan H. Balliu

I II III IV = (II-III) V VI = I-IV - V

VITI	Të ardhura	Pasuria	Detyrime	Pasuria neto	Shpenzime	Rezultati
1994 - 2002	3 657 053	5 156 040	0	5 156 040	1 961 450	-3 460 437
2003	1 422 837	0	0	0	381 892	1 040 945
2004	857 074	3 000 000	0	3 000 000	609 328	-2 752 254
2005	552 324	482	0	482	71 561	480 281

2006	678 687	-479 690	0	-479 690	705 945	452 432
2007	5 363 313	3 980 540	0	3 980 540	963 691	419 082
2008	1 384 982	435 374	0	435 374	1 376 831	-427 223
2009	2 256 563	-435 399	0	-435 399	1 581 175	1 110 787
2010	2 185 877	1 452	0	1 452	782 457	1 401 968
2011	2 157 307	2 367	0	2 367	987 336	1 167 604
2012	2 201 829	3 491 244	0	3 491 244	943 690	-2 233 105
2013	2 327 811	596	0	596	1 256 501	1 070 714
2014	2 878 005	405 530	0	405 530	2 114 185	358 290
2015	2 929 421	24	0	24	2 475 202	454 195
2016	2 956 566	2 519 202	0	2 519 202	2 604 236	-2 166 873
<b>TOTAL</b>	<b>33 809 649</b>	<b>18 077 761</b>	<b>0</b>	<b>18 077 761</b>	<b>18 087 714</b>	<b>-11 039 892</b>

Bazuar në analizën financiare, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për vitet 1994 – 2016, në vlerën totale -11.039.892 lekë.

### Të ardhurat

- Përfshirja e të ardhurave nga qiratë është bërë vetëm për ato të dokumentuara dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore përkatëse për vitet 2014 - 2016.
- Për sa i takon të ardhurave nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në analizën financiare përfshihet 1/3 e shumës që i ka kaluar znj. R. B., meqë kjo është pjesa që i takon me ligj.  $1/3 * 652.190 = 217.397$  lekë.
- Komisioni nuk përfshiu të ardhurat nga interesi nga bonot e thesarit për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm e krijimit të kësaj pasurie.
- Komisioni nuk përfshiu në analizën financiare deklaratimet e subjektit lidhur me gjendjen *cash* të krijuar ndër vite. Llogaritja e gjendjes *cash* është bërë nga Komisioni, bazuar në deklaratimet periodike vjetore të paraqitura nga subjekti në deklaratat e dorëzuara ndër vite në ILDKPKI.
- Në analizën financiare janë pasqyruar të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes, bazuar në dokumentacionin e sjellë nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>3</sup>.
- Në analizën financiare janë reflektuar edhe të ardhurat e deklaruara nga subjekti për vitet e punës si hetues pranë Prokurorisë së Rrethit Pogradec, si dhe nuk janë përfshirë shpenzimet e jetesës për periudhën që subjekti kishte trajtim të veçantë.

### Shpenzimet

- Në analizën financiare, shpenzimet e arredimit të apartamentit në Rr. “\*\*\*\*” janë deklaruar në vlerën 550.000 lekë. Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit për ndarjen e këtyre shpenzimeve sipas viteve, por subjekti deklaroi se janë bërë gjatë gjithë viteve derisa është shitur si pasuri, por pa specifikuar vitet dhe vlerat përkatëse. Në rezultatet e hetimit këto shpenzime u shpërndanë në dy vitet e para, sepse Komisioni krijoi bindjen se këto janë shpenzime që bëhen në vitet e para të blerjes së një apartamenti në mënyrë që të jetohet në të.

<sup>3</sup> Shikoni shkresën e ISSH-së, në përgjigje të rezultateve të hetimit të dërguara nga subjekti i rivlerësimit.



- Në analizën financiare, shpenzimet e arredimit të apartamentit në Kavajë, janë deklaruar në vlerën 450.000 lekë. Subjekti është pyetur për ndarjen e këtyre shpenzimeve sipas viteve, i cili deklaroi se këto shpenzime janë bërë ndër vite. Në rezultatet e hetimit këto shpenzime janë shpërndarë në dy vitet e para, sepse janë shpenzime që bëhen në vitet e para të blerjes së një apartamenti, me qëllim që të jetohet në të.

Subjektit, për gjetjet dhe konstatimet e mësipërme, iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimet e bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, paraqiti shpjegime lidhur me shpenzimet e kryera për arredimin, sipas viteve dhe vlerave përkatëse, të cilat u morën në konsideratë nga Komisioni dhe u reflektuan në analizën financiare. Gjithashtu, në analizën financiare u reflektuan edhe shpjegimet e subjektit lidhur me shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e jetesës në vitin 2005.

Komisioni, për këtë analizë financiare, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk arriti të paraqesë prova dhe dokumentacion justifikues për të provuar të kundërtën e disa gjetjeve të konstatuara prej tij.

### **KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në njërin prej kriterëve të vlerësimit, atë të pasurisë, në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat e administruara nga Komisioni, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti e rivlerësimit, z. Arjan Balliu:

- ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1991 – 2016;
- ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për të ardhurat;
- ka bërë deklaram të pasaktë dhe të rremë lidhur me pasuritë e krijuara dhe burimin e ligjshëm;
- ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;
- nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij dhe personave të lidhur, në kuptim të nenin D, të Aneksit të Kushtetutës;
- është gjendur në situatën e konfliktit të interesit.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare dhe në bazë të gurmës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arjan Balliu, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 18.11.2019.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Xhensila PINE**  
**Kryesues**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Anëtar**

**Roland ILIA**  
**Relator**

*Gledis Hajdini*  
*Sekretare gjyqësore*